

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit, H. (M.) Z. nga P., rruga “...” pn. për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.4780-2/2009 të dt.13.01.2014, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 28.01.2016, në praninë e Prokurorit të Shtetit Fatmir Behrami, të dëmtuarit A. A., të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij sipas autorizimit av. M. H. nga P., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 02.02.2016, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari H. Z., i biri i M. dhe nënës H., e vajzërisë S., i lindur më dt.*data e lindjes...*, në P. Komuna e P. tani me vendbanim në P., rruga “...” pn., me numër personal të identifikimit: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me pension të veteranit, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar baba i 9 (nëntë) fëmijëve, pa të dhëna se më parë ka qenë i gjykuar i dënuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në arrest shtëpiak prej datës **në kohëzgjatje 30 (tridhjetë ditësh) prej datës 05.01.2010.**

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt.29.12.2009, rreth orës 07:45, në rrugën Podujevë-Prishtinë, në fshatin P., derisa policët i dëmtuari B. H. dhe polici i dëmtuari A. A., kanë qenë në detyrë zyrtare të ruajtjes së rendit publik, i pandehuri H. Z., duke e drejtuar veturën e tij në drejtim të Prishtinës, e tejkalon shpejtësinë dhe bie në radar dhe për këtë e ndalon policia, dhe polici i dëmtuari A. A., i thotë të pandehurit të dal nga vetura dhe ti jap dokumentacionin e veturës, mirëpo pas një fjalosje në mes veti i pandehuri me dashje që ti shkaktoj lëndime trupore të dëmtuarit policit A. A., e sulmon dhe e godet me grushte në fytyrë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore, në formë të kontuzioneve të buzëve të gojës me dëmtim të përkohshëm të shëndetit.

-Me këtë në kryer veprën penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 3,4,7,8,17,23,41,42,43,45,73,83 par.1, nenit 410 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365,450,453,463,370 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin H. (M.) Z., me dënim me burg, në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muajve**, të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Konform nenit 83 par. 1 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej **30 ditësh, prej datës 05.01.2010.**

III. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej **40.88** (për dy ekspertiza mjeko-ligjore), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **50€ (pesëqind euro)**, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. I dëmtuari zyrtari policor B.H., për realizimin e kërkesës pasurore - juridike, udhëzohet në kontest të rregullt juridiko- civil.

Pas shpalljes së aktgjykimit, gjykata konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, duke iu llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak prej 30 ditësh, i mbetur prej 5 (pesë) muajve burg, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej **1000 euro, (njëmijë euro)** të cilin dënim është i obliguar ta paguaj brenda afatit prej **30 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se nuk e paguan mbetet në fuqi dënimin me burgim.

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë, tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.4780-2/2009 dt.13.01.2014, kundër të akuzuarit H.Z. nga P., rruga "...” pn, për shkak të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 317 par.2 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 16.02.2015, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i shtetit, i dëmtuari A. A., i akuzuari dhe mbrojtësi i tij av. M. H..

I akuzuari në seancën e shqyrtimit fillestar pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij av.M. H., ka deklaruar se në tërësi e pranon fajësinë për të gjitha pikat e

aktakuzës, duke shtuar se ndien keqardhje për të dëmtuarin, pendohet për ato veprime që i ka ndërmarr, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëris kurrfarë veprash penale.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar pa leximit të aktakuzës e ka bërë plotësimin e dispozitivit të aktakuzës në rreshtin e dytë ku duhet të jetë i dëmtuari polici B. H., dhe lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se pajtohet me pranimin e fajësisë të pandehurit pasi që i njëjti e ka bërë me vetëdije të plotë dhe pas konsultimit edhe me mbrojtësin e tij, dhe i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovoj, ndërsa me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim të merr rrethanat lehtësuese dhe rënduese si dhe të merret parasysh pranimi i fajësisë.

I dëmtuari A. A. lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari ka dhënë mendimin duke deklaruar se ja lë gjykatës që të vendos, ndërsa nuk parashtroi kërkesë pasurore-juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. M. H. në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë dhe ju ka kërkuar falje të dëmtuarve, duke ju dërguar ndërmjetësues për tu rregulluar sipas traditës sonë, dhe me rastin e marrjes së vendimit gjykata të ketë parasysh, pranimin e fajësisë, është i gjendjes së dobët ekonomike, me gjendje shëndetësore jo të mirë, me nënë fëmijë, mbajtës i 11 anëtarëve, siguron vetëm një pension prej 170 euro, deri me tani nuk ka qenë në kundërshtim me ligjin.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar edhe nga i akuzuari dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit të dëmtuarit dhe mbrojtësit të akuzuarit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë vullnetarisht, gjykata e vlerësoi dhe analizoi se pranimi i fajësisë ka mbështetje në prova që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata duke vepruar sipas detyrës zyrtare zbaton ligjin më të favorshëm në kuptim të nenit 3 par.2 të KPRK-së, i cili ka hyrë në fuqi me 01.janar.2013, është më i favorshëm për arsye se është paraparë mundësia e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë deri në gjashtë (6) muaj, për dallim nga kodi i mëparshëm që ka qenë vetëm deri tre (3) muaj burg, mbi këtë bazë u bë rikualifikimi në vepër të njëjtë dhe atë: nga vepra penale për shkak të veprës sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare

nga neni 317 par.2 të KPK-së, në vepër penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari e ka kryer veprën me dashje, nga se ka qenë i vetëdijshëm për veprimet tij dhe ka dashur kryerjen e veprës penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti vetëm faktin se i akuzuari në shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, kishte sjellje të mira gjatë shqyrtimit fillestar, ndien keqardhje për rastin, për herë të parë ka ra në kundërshtim me ligjin, të gjitha këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese në dobi të akuzuarit. Duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se shkallën e lartë të dashjes për mos respektimin e zyrtarëve policor në detyrë duke përdor dhunën, motivet e kryerjes së veprës penale ishin për shkak të tiketës së shqiptuar nga zyrtarët policor. Andaj duke vlerësuar këto rrethana, gjykata të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Kjo veprë penale është shumë e shpeshtë në vendin tonë, duke mos i respektuar institucionet dhe zyrtarët në ushtrimin e detyrave brenda fushë veprimtarisë së tyre ligjore. Dhe kjo gjykatë konsideron se dënimet e shqiptuara në këto raste duhet të jenë në proporcion me shkallën e lartë të rrezikshmërisë shoqërore të këtyre veprave penale.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjkata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale, të gjitha këto të parapara me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar u muar në kuptim të nenit 83 par.1 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.1. dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal
P.nr.49/14,dt.02.02.2016

Sekretare Juridike
Mihrie Sheholli-Krasniqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.